

## **NJË KAMP DY LUFTRA**

Nga Zhuljeta Kadilli (Daja), Kolegji Universitar “Beder”

### *Abstrakt*

Nëpërmjet këtij artikulli synojmë të trajtojmë faktin se si një territor në Tepelenë u kthye në një kamp ku u zhvilluan dy luftëra. Qyteti i Tepelenës shtrihet në kryqëzimin e rrugëve gjatë Vjosës, në daljen nga gryka e Këlcyrës, gjatë Drinosit për në Mallakastër. Së bashku edhe me kështjellën e ndërtuar nga Ali Pashë Tepelena, ishte një pikë strategjike, të cilën gjatë Luftës së Dytë Botërore ushtria italiane e përdori për vendosjen e garnizoneve ushtarake, duke e kthyer në një kamp fushimi të saj. Për vetë pozicionin gjeografik ky kamp u bë pjesë e betejave gjatë Luftës Italo-Greke, që filloi në tetor të vitit 1940. Por ai që e bëri të njohur Tepelenën, me një konotacion negativ, është kampi i ndërtuar gjatë regjimit komunist (1949). Ky kamp u përdor si strukturë internimi nga ky regjim. Regjimi komunist filloi një luftë të ashpër civile ndaj grupit kundërshtar, grupit që nuk u bashkua me komunistët. Jo vetëm dënimet me gjyqet popullore, por edhe internimet u bënë pjesë e asgjësimit të kundërshtarëve politikë. U gjetën kampe ku u mbajtën familjarët e të dënuarve, të kundërshtarëve, të të arratisurve dhe ushtarakëve dezertorë. Në to pati edhe një numër të madh fëmijësh të cilët për shkak të kushteve të rënda vdiqën. Për të realizuar artikullin jemi mbështetur në literaturë historiografike dhe dëshmitë e personave të ndryshëm, të cilët e kanë njohur jetën në këtë kamp. Në përfundim, mizoria, përdhosja, masakra janë teknikat e përshtatshme të luftës, përmes tyre do të arrihet qëllimi e të zhduket grupi tjetër. Sot Tepelena ka një tjetër pamje dhe përmbajtje, edhe kampi gjithashtu. Ai thjesht është në libra dhe memorien historike, por nuk duhet të harrohet, në të kundërtën përsëritet.

*Fjalë kyçe: kamp internimi, Lufta Italo-Greke, masakra, luftë civile, Tepelenë*

### *Hyrje*

Tepelena është një qytet në pjesën jugore të Shqipërisë, në faqen e një kodre në të majtë të Vjosës, pranë bashkimit me Drinon. Historiku i themelimit të Tepelenës si qytet, pikërisht këtu, lidhet me vendbanimin e hershëm të shënuar me një kështjellë të shek. IV-VI. Kjo kështjellë është ngritur në një pikë strategjike, në kryqëzimin e rrugëve gjatë Vjosës, në daljen nga gryka e Këlcyrës, gjatë Drinosit për në Mallakastër<sup>1</sup>. Ka një sipërfaqe së bashku me rrethinat prej 817

---

<sup>1</sup> Akademia e Shkencave e RPSSH-së, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 1084.

km katrore<sup>2</sup>. Që nga shek. VI deri në shek. XIX ka disa faza zhvillimi, gjurmë të të cilit ruhen edhe sot. Në 1492 u shkatërrua gjatë pushtimit osman, për t'u ndërtuar një kështjellë më e vogël, e cila ruhet edhe sot. Në shek. XVII Tepelena kishte 250 shtëpi. Në 1789 Tepelenën e shtiu në dorë Ali Pasha, që ngriti aty edhe sarajet e veta<sup>3</sup>. Më 1819 Ali Pasha përfundoi një kështjellë prej 4-5 hektarë. Muret me gurë të gdhendur e të zbukuruara me korniza janë të pjerrëta e të përshtatshme për artilerinë. Brenda tyre ishin mjediset për garnizonin dhe banesa të tjera<sup>4</sup>. Qyteti i Tepelenës gjatë Rilindjes Kombëtare ka qenë pjesë aktive saj. Edhe pas Shpalljes së Pavarësisë, dhe, veçanërisht faktit që ishte pranë Vlorës, Tepelena do të bëhej pjesë e zhvillimeve politike. Në Qeverinë e Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali, filluan konfliktet midis grupeve të ndryshme, të cilat çuan në dorëheqjen e Ismail Qemalit më 22 janar të vitit 1914<sup>5</sup>. Pas dorëheqjes pati zhvillime politike interesante në shtetin shqiptar. Ndër më të rëndësishmet mund të përmendim ardhjen në Shqipëri të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe më 7 mars 1914 të Princ Vidit, si rezultat i boshllëkut institucional të krijuar nga dorëheqja e Ismail Qemalit.

Në 28 korrik 1914 filloi Lufta e Parë Botërore dhe për këtë arsye më 3 shtator 1914 Princ Vidi u largua nga vendi ynë. Largimin e Princ Vidit e kushtëzoi jo vetëm fillimi i Luftës së Parë Botërore apo Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, por edhe Austro-Hungaria apo Italia e kërkonin këtë gjë. Austro-Hungaria ishte e interesuar që të hidhte shqiptarët kundër Serbisë dhe kjo mund të arrihej vetëm me largimin e Princ Vidit. Për Italinë, largimi i Vidit i krijonte qeverisë së Romës mundësinë për të arritur lehtë synimet e saj, që të vendoste ushtarët italianë në Shqipëri dhe sidomos në Vlorë<sup>6</sup>. Me largimin e kryetarit të shtetit, Shqipëria mbeti pa pushtet qendror legjitim të njohur ndërkombëtarisht, që të kishte të drejtën të përcaktonte qëndrimin e vendit ndaj Luftës së Parë Botërore. Pushteti i Esat Pashë Toptanit, i vendosur në një pjesë të Shqipërisë së Mesme, në tetor 1914 nuk e kishte këtë të drejtë, prandaj të gjitha shpalljet dhe qëndrimet e tij nuk kishin vlerë juridike. Gjithsesi, Italia, Greqia dhe Serbia e ndihmuan Esatin në ambiciet e tij, por pashai Toptanas nuk e zotëroi dot gjendjen.

Po kështu edhe përpjekjet e vendeve fqinjë për të shfrytëzuar krizën politike në Shqipëri nuk u kapërcyen lehtë. Shqiptarët e kuptonin lojën e Italisë dhe kundërshtuan politikën italiane,

---

<sup>2</sup> Wikipedia, Tepelena, parë më 10.08.2023, ora 9.

<sup>3</sup> Akademia e Shkencave e R.P.S.SH, *Fjalori enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 1084.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Shtëpia botuese "Toena", vol.III, Tiranë 2007, f. 57.

<sup>6</sup> Po aty, f. 75.

duke e quajtur të ndyrë, madje<sup>7</sup>. Në këto kushte Italia shmangu pushtimin ushtarak të Vlorës dhe më 29 tetor 1914 zbarkoi me një “mision humanitar”. Pas dy muajve, më 25 dhjetor 1914 Italia pushtoi Vlorën, duke zbarkuar në fillim forca të marinës luftarake dhe pas tri ditësh forca tokësore. I përmendëm këto të dhëna, pasi indirekt edhe Tepelena do bëhet pjesë e inkursioneve ushtarake të Italisë ndaj Vlorës.

Tepelena gjithashtu ka qenë qendër e rëndësishme e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Pas çlirimit u shndërrua në një qytet bujqësor dhe industrial. Gjithsesi, ato që i dhanë më së shumti emër Tepelenës, janë Lufta Italo-Greke dhe kampi i internimit që u krijua aty nga komunistët. E para është pjesë e inkursioneve të Luftës së Dytë Botërore, si rivalitet midis blloqeve të kësaj lufte, që mbase pa dashje Tepelena u bë pjesë e saj. E dyta, me ngritjen e kampit të internimit në vitin 1949. Që në fillim të ardhjes në pushtet, Partia Komuniste formësoi një politikë të asgjësuese ndaj kundërshtarëve të saj. Dhe janë pikërisht kampet e internimit, së bashku me format e tjera, si burgosjet, kampet e punës me anën e të cilave diktatura ushtroi një nga politikat më të tmerrshme në Shqipëri.

### *1. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia dhe zhvillimet e para politike*

Më 9 prill 1939, sapo u futën në Tiranë, pushtuesit italianë, të pashqetësuar shumë nga forcat e armatosura shqiptare, përpunuan planin për aneksimin duke joshur zyrtarë të mëparshëm shqiptarë, armiq politikë të Zogut, në mënyrë që të siguronin bashkëpunimin e tyre. Ata krijuan Komitetin e Përkohshëm Administrativ nën kryesinë e Xhaferr Ypit. Xhaferr Ypi thirri “Asamblenë Kushtetuese”, që përbëhej nga 159 anëtarë, kryesisht pronarë të mëdhenj tokash, bajraktarë, tregtarë dhe klerikë. Kjo asamble bëri gjithçka për të ç’bërë politikisht çdo gjë që ishte arritur deri më 1939-ën. Nga ky moment, sidomos, kur edhe Asambleja vendosi bashkimin e Shqipërisë me Italinë nën kurorën mbretërore të Viktor Emanuelit III, filloi të nxisë popullsinë për besim tek Italia. Pas këtyre veprimeve Italia mori masa që nga krijimi i qeverisë pro saj, deri në qelizë të pushtetit lokal<sup>8</sup>. Morën masa edhe në fushën ekonomike dhe sociale. I kushtuan rëndësi të madhe edhe propagandës, duke censuruar shtypin shqiptar dhe mbylljes së shkollave të huaja joitaliane që funksiononin në Shqipëri. Ata hapën edhe shkolla të reja, por me programe sipas interesave të tyre duke futur njëkohësisht edhe mësimin e gjuhës italiane me detyrim.

---

<sup>7</sup> Po aty, f. 77.

<sup>8</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-1990*, shtëpia botuese “Kristalina K-H”, Tiranë 2007, f. 211-212.

Musolini mori një varg masash për të izoluar Shqipërinë nga bota demokratike. Largoji misionin francez të arkeologjisë, madje edhe fondacionin amerikan “Rokfeler”, si dhe u ndalua futja e gjithë literaturës së huaj, me përjashtim të atyre që vinin nga Italia<sup>9</sup>.

Në këtë mënyrë Italia ndihej e sigurt në pushtimin e Shqipërisë, pse jo, ajo mundet të kishte edhe pikësynime të tjera, që mund t’i vinin në mendje nga kohët e lavdishme të Romës. Pushtimi i Shqipërisë dhe përfshirja e saj në përbërje të së ashtuquajturës “Perandori italiane”, solli për pasojë krijimin në vend të një strukture politiko-shoqërore, e cila qe një kopje në miniaturë e të gjitha hallkave kryesore të regjimit fashist të vetë Italisë<sup>10</sup>. Pas kësaj kemi një veprimtari të tërë ndërtuese në të gjitha fushat. Në 11 prill 1939, pas gati 19 vjetësh italianët u rikthyen në Tepelenë. Tepelena u zgjodh qendra kryesore e Jugut, nga ku mund të fillonte mobilizimi. Zgjedhja e Tepelenës nuk qe rastësore, ajo lidhet me pozicionin strategjik dhe sigurisë që ata kishin në këtë rajon. Në godinat ekzistuese poshtë Tepelenës filluan ndërtimet e reja ushtarake. Ushtarët xhenierë që ditët e para filluan ndërtimet sipas një plani të miratuar. Ndërsa në Luftën e Parë Botërore numri i ushtarëve italianë në Tepelenë ishte deri 300-400 ushtarë, në vitet 1940 dhe sidomos në Luftën Italo-Greke do të arrinte mbi 10 mijë ushtarë<sup>11</sup>. Në 7 prill 1939 Italia pushtoi Shqipërinë, veprim ky që paralajmëroi fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Nga ana tjetër, në shtatorin e vitit 1939, Musolini nuk e pasoi Hitlerin, duke deklaruar “mospjesëmarrjen” e përkohshme në konfliktin e armatosur. Sigurisht, kjo ishte një lëvizje e rafinuar e Italisë. Synimet e saj ishin të qarta tashmë. Nga ana tjetër, ajo nuk e shihte veten të gatshme për t’u futur në luftë kundër perëndimit dhe në këtë mënyrë zgjodhi të forcojë pozitën ekonomike dhe politike në vendet e pushtuara. Fiks kur Franca u shpartallua nga Gjermania, politikanët e Romës ndjenë se mund të mos bëheshin pjesë e ndarjes së Evropës. Për këtë arsye ajo i shpalli luftë Francës dhe në këtë mënyrë mori pjesë në nënshkrimin e armëpushimit. Orekset e Musolinit u ndezën dhe në rend të ditës u vunë planet për pushtimin e Ballkanit<sup>12</sup>. Në verën e vitit 1940 Shtabi i Përgjithshëm Italian diskutonte lidhur me planet për pushtimin e Jugosllavisë apo Greqisë. Në varësi të synimeve ndryshonte edhe propaganda që bëhej në Shqipëri, së cilës i premtuhej mbështetje në mëtimet e saj herë për Kosovën, herë për Çamërinë. Pikërisht në vjeshtë u zgjodh Greqia për t’u sulmuar.

---

<sup>9</sup> Po aty, f. 213.

<sup>10</sup> Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë për gjatë shekullit XX*, Shtëpia Botuese “Ideart”, Tiranë 2003, f. 211.

<sup>11</sup> Xhezo Canaj, *Historia e ndërtimit të kazermave ushtarake në Tepelenë, Lufta Italo-Greke*, kumtesa e mbajtur në simpoziumin, “Tepelena në dy kohë”, gusht 2023, f. 2.

<sup>12</sup> Po aty, f. 214.

## 1. Lufta Italo-Greke

Sulmi italian ndaj Greqisë filloi më 28 tetor të vitit 1940. Ushtria italiane filloi mësymjen kundër Greqisë me tetë divizione. Britania i dha një mbështetje të madhe ushtarake. Duke shfrytëzuar terrenin e thyer dhe organizimin e dobët italian, forcat greke e thyen shpejt dhe në mesin e nëntorit kaluan në kundërsulm. Qeveria Vërlaci nga ana e saj i shpalli luftë Greqisë duke u bërë pjesë e agresionit fashist italian mbi Greqinë. Gjithsesi fushatat nuk ecën sipas parashikimeve, grekët patën përparësi në fazën e parë. Më 22 nëntor grekët pushtuan Korçën dhe më 8 dhjetor Gjirokastrën. Këtë herë qëndrimi i ushtrisë greke që më i butë ndaj popullsisë shqiptare në krahasim me atë të viteve 1912-1914, por gjithsesi që një veprim sistematik për shkatërrimin e kishave dhe të xhamive të shqiptarëve në zonat ku u fut ushtria greke<sup>13</sup>. Këto objekte u rregulluan më vonë nga italianët, me synimin për të rregulluar marrëdhëniet me popullsinë vendase<sup>14</sup>. Pas pushtimit të territoreve shqiptare nga ushtria greke, sulmi u ndal. Një pjesë e ushtarëve shqiptarë, duke mos pranuar luftën kundër Greqisë, dezertuan; megjithatë gjenerali Metaksa dha urdhër që këta ushtarë të internoheshin dhe të mos lejoheshin të luftonin në anën e grekëve.

Në këto kushte, duke qenë se italianët nuk mundën t'i mposhtnin grekët nëpërmjet forcës së armëve, siç edhe menduan, dhe për të fituar kredibilitet në sytë e shqiptarëve, më 7 gusht 1941, me dekret të Viktor Emanuelit III, shpallën krijimin e “Shqipërisë së Madhe” e cila do të inkuadronte gjithë shqiptarët e Ballkanit. Edhe pse u prit mirë si zgjidhje, kjo nuk mjaftoi që italianët të fitonin ndonjë mbështetje jetëgjatë në Shqipëri. Pas shumë përpjekjeve nga të dyja palët betejash, aventura greke e fashizmit italian pati një fund të palavdishëm për të tria vendet.

## 2. Fillesat e Kampit të Tepelenës

Historia e fillimit të Kampit të Tepelenës është me e hershme se Lufta Italo-Greke, madje edhe më e hershme se fillimi i Luftës së Dytë Botërore. Që gjatë Luftës së Parë Botërore Tepelena ka shërbyer si vend strategjik për ushtrinë italiane. Më 20 dhjetor 1914 Këshilli i Senatit të Durrësit, Qeveria e Esat Pashës, miratoi një dokument, i cili u lejonte trupave italiane “të zbarkonin lirisht në çfarëdo pike të Shqipërisë”, pra edhe në Vlorë, duke e motivuar këtë me

---

<sup>13</sup> Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar, 1939-1949*, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë 2002, f. 50.

<sup>14</sup> Po aty, f. 51.

nevojën e zhdukjes së anarkisë.<sup>15</sup> Zonat që përfshinte fillimisht pushtimi i Italisë në Luftën e Parë Botërore ishin: Vlora, Gjirokastra, Tepelena, Përmeti, Kolonja dhe Saranda.

Qendrat e vendosjes së italianëve ishin Vlora dhe Gjirokastra. Një kompani që arrinte 300 ushtarë u vendos në Tepelenë, ndërsa një kompani me 50-60 vetë në Matohasanaj. Vetë Tepelena atëherë kishte jo më shumë se 270 banorë. Lëvizja patriotike mori përmasa të mëdha. Në vitet 1916-1917 u zhvillua një veprimtari e madhe patriotike me pjesëmarrjen e Avni Rustemit, që punonte si mësues në këtë qytet<sup>16</sup>. Qendra e kompanisë ushtarake në Tepelenë për herë të parë u vendos në Kala, dhe italianët ndërtuan mbi Tepelenë disa ndërtesa për mbajtjen e kafshëve të luftës. Në Kala u ndërtua gjithashtu një ndërtesë e veçuar ku ishte vendosur Komanda Ushtarake<sup>17</sup>.

Në vitet 1917-1918, tek vendi ku më vonë u ndërtua kampi internimit, italianët filluan të ngrinin disa ndërtesa. Ndërtimi poshtë qytetit të Tepelenës lidhej me pozicionin e favorshëm si vend që mbrohej nga erërat dhe mund të furnizohej me ujë nga Lumi i Bënçës. Në këtë kohë italianët hapën edhe rrugën automobilistike, që lidhte me Tepelenën me Vlorën<sup>18</sup>.

Në vitin 1918 u krijua klubi “Bashkimi”, që do të ndikojë në lëvizjen patriotike të Vlorës e zonave përreth. Vlora ishte e pushtuar nga italianët që gjatë Luftës së Parë Botërore. Zhvillimet politike të ndodhura në Shqipëri në vitin 1920 mundësuan mbajtjen e Kuvendit të Barçallasë më 29 maj 1920, i cili vendosi fillimin e luftës për çlirimin e Vlorës. Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” vendosi pikërisht datën 5 qershor për fillimin e luftës, pasi gjenerali S. Piaçentini hodhi poshtë ultimatumin për dorëzimin paqësisht Vlorën qeverisë së Tiranës<sup>19</sup>.

Më 5-6 qershor nga luftëtarët vlonjatë u goditën njëherazi të gjitha garnizonet armike të krahinës, që nga Tepelena e deri në Drashovicë, me përjashtim të atij të Vlorës. Sulmi për çlirimin e Vlorës filloi më 11 qershor, pasi kishin rënë të gjitha me përjashtim të Tepelenës, e cila u dorëzua më 21 qershor. Gjatë luftës së Vlorës më 1920 banorët e Tepelenës dhanë ndihmesë për dëbimin e italianëve nga kazermet që ishin në kala.

---

<sup>15</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Shtëpia botuese “Toena”, vol. III, Tiranë 2007, f. 77.

<sup>16</sup> Akademia e Shkencave, *Fjalori...*, vep. e cit., f. 1084.

<sup>17</sup> Xhezo Canaj, *Historia e ndërtimit të kazermave ushtarake në Tepelenë, Lufta Italo-Greke*, kumtesa e mbajtur në simpoziumin, “Tepelena në dy kohë”, gusht 2023, f.1.

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar...*, vep. e cit., f. 642.

Ky fakt tregon, së paku, se në Tepelenë në këtë kohë ka ekzistuar një kamp fushimi ku ishin vendosur trupat italiane. Me pushtim italian në 1939, Vlora përsëri ishte në pikësynimet e Italisë. Nëpërmjet pushtimit të Vlorës Italia mund të kontrollonte gjithçka, jo vetëm Adriatikon, por edhe gjithë Ballkanin<sup>20</sup>. Gjatë pushtimit italian të Shqipërisë, rrëzë kalasë së Tepelenës, u ndërtuan disa kazerma nga ushtria në fillimet e Luftës Italo-Greke. Italia jo vetëm që e njihte nga historia si zonë, por ishte edhe strategjikisht e favorshme. Gjatë Luftës Italo-Greke luftimet u zhvilluan për afro gjashtë muaj në territoret shqiptare. Sigurisht, që nga pala italiane u përdorën edhe garnizonet të vendosura në Tepelenë. Tepelena ishte një kamp që u shërbeu si bazë italianëve. Janë të njohura edhe në histori luftimet që u zhvilluan në zonën e Dragotit të Tepelenës dhe të fshehtat e fushës së Sajmolit gjatë kësaj lufte. Gjithsesi, pas çlirimit në këtë zonë mbetën mina apo armë të tjera nga lufta. Fushat e kampit u minuan. Ky është fundi i këtij kampi për fazën e parë të luftës së popullit shqiptar, dëshmitar i së cilës është vetëm lumi Vjosa dhe territori ku ishte ngritur kampi.

### *3. Kampet e internimit gjatë periudhës komuniste*

Pas çlirimit të Shqipërisë Partia Komuniste u kthye në të vetmen forcë reale që kishte pushtetin në dorë. Që gjatë luftës komunistët kishin shtypur dhe asgjësuar çdo lloj qëndrese antikomuniste. Tashmë Partia Komuniste, duke kontrolluar të gjitha pushtetet, realisht kishte hedhur themelet mbi të cilat do të ngrihej pushteti i ardhshëm. Sigurisht për të arritur atje ku duhej, përveç propagandës, komunistët filluan të ndërmerrnin edhe hapa konkretë për të mos lejuar mëkëmbjen e opozitës. Hapi i parë dhe më kryesori ishte goditja e opozitës dhe kundërshtarëve politikë. Nën emërtimin si bashkëpunëtorë të fashizmit dhe armiq të popullit, atyre iu hoq e drejta të merrnin pjesë në jetën politike. Jo vetëm kaq, por ato po përndiqeshin dhe dënoheshin me mënyra nga më çnjerëzoret.

Nga mënyrat e asgjësimit të kundërshtarëve, veç pushkatimeve apo burgosjeve ishin edhe dëbim-internimet në kampe të ndryshme, në zona të izoluara të vendit. Pas marsit të vitit 1945 regjimi komunist ndjeu nevojën e shpërnguljes të familjarëve të kundërshtarëve të tij politikë. Ushtria komuniste, e vendosur në qendrat e qyteteve kryesore, filloi grumbullimin e kontingjentëve të parë kundërshtarë, para hapjes së kampeve të para të internimit. Të grumbulluarit e parë në qytetin e Lezhës ishin 44 të internuar dhe atyre u jepej 30.8 kg. bukë

---

<sup>20</sup> Bernd Ficher, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Shtëpia botuese “ÇABEJ”, Tiranë 1999, f. 29.

në ditë<sup>21</sup>. Si kampe të përqendruara internimi u përzgjedhën vendet e në mënyrë artizanale filloi ndërtimi (rrethimi i tyre). Kruja dhe Berati<sup>22</sup> ishin vendet e para ku u përqendruan të internuarit<sup>23</sup>. Territori ku ishte shtrirë kampi ishte një vend i rrethuar me tela me gjemba, i ruajtur nga anët kryesore me roje të armatosura. Nuk lejohej dalja nga kampi, përveç rasteve shumë të veçanta, me leje të posaçme. Kampet ishin të përshtatura në godina të vjetra, si depo repartesh, magazina ose baraka të përshtatura, por pa asnjë mjet jetese. Në këto mjedise duhej të jetonin kundërshtarët politikë. Në këto kampe të internimeve kishte vetëm mjerim e vuajtje. Ishte e qartë që frymëzimi i parë për ndërtimin e tyre kishin qenë disa prej kampeve naziste, aq të pëlqyera për t'u ndërtuar nga komunistët<sup>24</sup>. Internimi në vitet 1945-1949 bëhej pa asnjë bazë ligjore, ai bëhej nga strukturat e ushtrisë komuniste. Madje kishte edhe raste kur personat rrëmbeheshin dhe mbylleshin në një vend larg vendbanimit të tij. Është e paimagjinueshme se si në vitin 1949 fëmijët ishin kontingjenti kryesor i kampeve të përqendrimit. Pas 1949 kishte ligj të posaçëm për dëbim-internimet.

Pra diktatura komuniste në Shqipëri, nga më të egrat në vendet e Lindjes, u ushtrua edhe në një formë të tmerrshme, nëpërmjet internimit. Kampet e internimit, për nga mënyra se si funksionuan, si qendra të vuajtjes dhe të izolimit, imponimi i punës së detyruar, kequshqyerja dhe torturat, për shumicën e të internuarve ishin si kampet e vdekjes: *“Shqipnija e terrorizuese kishte ra në koma. Njerëzit e ditur nuk dijsin ma kurrëgjja dhe njerëzit e paditun kishin në dorë gjithshka: atë që nuk dihej”*<sup>25</sup>.

#### 4. Kampi i Tepelenës në vitet 1949-1954

Një nga këto kampe është edhe ai i Tepelenës, për të cilin nuk dihen shumë hollësi. Ky kamp u ngrit në prill të vitit 1949 dhe funksionoi deri në mars 1954. Fillesat e kampit të Tepelenës lidhen me transferimin e kampit të Beratit në Tepelenë. Mendoj se ky transferim u bë për dy arsye: së pari Tepelena ofronte kushte gjeografike më të mira dhe Tepelena ishte nën juridiksionin e Degës së Punëve të Brendshme të Beratit. Gjatë transferimit të të internuarve

---

<sup>21</sup>Kastriot Dervishi, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë Komuniste*, Shtypshkronja “Maluka”, Tiranë 2015, f. 10.

<sup>22</sup>Shënim. Kampi i Krujës ndodhej brenda qytetit, në një repart ushtarak. U ndërtua në mars të 1947 dhe funksionoi si i tillë deri në korrik 1947. Të internuarit jetonin me 600 gr. bukë misri në ditë, e cila paguhej prej tyre. Ata shfrytëzoheshin me detyrim në punë. Kampi i Beratit ka qenë kryesisht në lagjen “Çelepias”. Kampi ka funksionuar nga viti 1945 deri në vitin 1949. Të internuarit e kampit të Beratit punonin në fermën e Kuçovës. Sipas, Kastriot Dervishi, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri, *Burgjet dhe...*, vep. e cit., f. 15.

<sup>23</sup> Kastriot Dervishi, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri, *Burgjet dhe...*, vep. e cit., f.10.

<sup>24</sup> Po aty, f. 11.

<sup>25</sup>Courtois-Werth-Panne- Paczkoëski-Bartosek-Margolin, *Libri i zi i komunizmit*, Shtëpia Botuese “Besa”, Tiranë 2000, f. 596.



nga Berati në Tepelenë, pati të vdekur si rezultat i përmbysjes së makinës që i transportonte. Në këtë aksident mbetën të vdekur dy persona, prindër të katër fëmijëve, të cilët i lanë jetimë dhe u plagosën disa të tjerë<sup>26</sup>. Përpara se të internuarit të vendoseshin në Tepelenë, u vendosën në fshatrat pranë saj, si: Turani, Memaliaj dhe Veliqoti. Pasi këto fshatra nuk kishin asnjë mundësi për të vazhduar si kampe dhe vdekshmëria ishte e lartë, kampi u vendos në afërsi, apo poshtë Tepelenës<sup>27</sup>. Kampi i Tepelenës u ngrit pikërisht mbi atë territor, që kishte shërbyer si vend për ngritjen e kazermave të ushtrive Italiane. Këtu, në fushën poshtë qytetit, ekzistonin 6 kazerma të ushtrisë italiane<sup>28</sup>. Ato u përshtatën si vende banimi, u rrethuan me tela me gjemba. Në çdo kazermë qëndronin rreth 200 persona<sup>29</sup>. Territori aty ishte i minuar, me predha të mbetura nga Lufta Italo-Greke. Ai ishte një ferr i vërtetë, ku vuajtën me mijëra, burra, gra e fëmijë. Në këtë kamp kishte të internuar nga e gjithë Shqipëria, por kryesisht mbizotëronin nga Veriu dhe Shqipëria e Mesme<sup>30</sup>.

U krijua sipas shembullit të kampeve të Bashkimit Sovjetik, si Siberia, por në përmasa të reduktuara me shkallën 1:10.000, përmasa 25 x 14 ku qëndronin 600 veta, sepse kishte shumë familje me fëmijë të vegjël. Kur filluan internimet e para në 1945, aludohej se qeveria komuniste shqiptare kishte vendosur t'i grumbullonte të internuarit dhe t'i niste për në Siberi me anije ruse<sup>31</sup>.

Për situatën në kamp mjafton të citojmë fjalët e të internuarit Lirim Biçaku, vetëm 7 vjeç<sup>32</sup>. Ja si e kujton ai: *“Në Tepelenë flinim në një kapanon të madh të kohës së luftës, ndërtuar nga italianët. Në tokë kishim shtruar nga një dërrasë dhe të gjithë qëndronim të radhitur si fishekë në karikator...Për 5 vjet s'e pamë kurrë ngjyrën dhe ngrohtësinë e zjarrit. Banjën e kishim 200 metra larg, në breg të lumit. S'e dinim se çfarë ishin ndërresat”*<sup>33</sup>.

Torturat janë nga më të ndryshmet dhe më të egrat, ashtu siç vetëm regjimet diktatoriale mund të bëjnë. Tortura shkon edhe më larg, këta njerëz nuk duhej vetëm të torturoheshin fizikisht, por edhe duhej të punonin. Të internuarit, sidomos gratë dhe fëmijët, bënin punë bujqësie ose transportonin si kafshë dru nga malet. Drutë e marra nga mali i Turanit, 7 km larg vendit,

---

<sup>26</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet...*, vep. e cit., f. 17.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Wikipedia, *Kampi i Tepelenës*, parë datë 12 gusht 2013, ora 19.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Shënim. Lirim Biçaku ishte vetëm 2 vjeç kur u internua. Shkaku ishte arratisja e gjyshit dhe babait të tij. Në vitin 1945 u internua në kampin e Beratit e Kuçovës e më pas, në moshën 7 vjeçare u transferua në kampin e Tepelenës.

<sup>33</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet...*, vep. e cit., f. 17.

përdoreshin për t'u ngrohur komanda, apo edhe dërgoheshin në qytet. Gratë e internuara mbledhnin pleh organik nëpër stanet e maleve të Tepelenës dhe e transportonin në kurriz me litarë<sup>34</sup>. Shembujt për torturimin dhe shfrytëzimin e të internuarve nëpër kampe janë të shumtë. Si rezultat i torturave dhe shfrytëzimit në vitin 1949 kishin vdekur 43 persona, prej të cilëve 28 fëmijë. Në janar-qershor të vitit 1950 fëmijët ishin pjesa mbizotëruese e kampit, numri i të cilëve arrinte në 554, 514 gra dhe 254 burra (shumica pleq)<sup>35</sup>. Këto shifra flasin vetë dhe nuk kanë nevojë për interpretim.

Kampi i Tepelenës qëndroi pesë vjet dhe u mbyll më 1954, kur të internuarit u grumbulluan të gjithë në fushën e Myzeqesë në Lushnje të shpërndarë në disa sektorë-kampe të fermës “29 Nëntori”, që u krijua në sajë të të internuarve. Vdekshmëria e madhe e fëmijëve në kampin e Tepelenës, të cilëve nuk u gjenden varret, por edhe nevoja për të konsoliduar institucionin e internimit solli mbylljen e kampit, por kjo nuk do të thotë se mbaruan vuajtjet dhe persekutimet për këtë kategori. Nuk do të njohim diktaturën pa njohur të fshehtat e burgjeve dhe kampeve të internimit. Gjithsesi mendoni vetë, por dëshmia më domethënëse janë varret e humbura.

##### *5. Të internuarit e Kampit të Tepelenës e më gjerë pas viteve 1990*

Pas vitit 1990 në Shqipëri si në vendet e Evropës Lindore ndodhi përmbyjsja e regjimit komunist. Mbase ishte moment që grupi i të persekutuarve, i cili kishte provuar represionin në breza, si gjatë luftës edhe gjatë komunizmit, të fitonte të drejtën, sidomos përmes rehabilitimit, të merrte pjesë në zgjedhje dhe pse jo t'i fitonte ato. Gjithsesi në emër të së drejtës së vet morale që buronte nga persekutimi, ky grup sërisht mund të synonte të fitonte zgjedhjet dhe pushtetin edhe pa vizion dhe material njerëzor, duke pasur edhe në këtë rast, probabilitet të mirë për të fituar pushtetin, por me siguri probabilitet shumë të vogël për ta mbajtur dhe ushtruar atë. Ne e dimë se për fat të mirë, ky grup në këto kushte, as nuk e synoi këtë “aventurë”.

Po ashtu, duhet të pranojmë (të arrijmë të kuptojmë qartë) sa më shpejt se konflikti brenda përbrenda shoqërisë që lind nga heterogjenia e natyrshme mes grupeve, e shndërron në një problem akut çështjen e pushtetit, se kush do të zotërojë mjetet e përbashkëta të dhunës dhe bindjes për t'i përdorur dhe për mbijetesën e shoqërisë si e tërë, por edhe për mbijetesën e grupit dominues mbi grupet e tjera. Kjo është gjendja e natyrshme e çdo shoqërie dhe në këtë kuptim sëmundja është gjendja e natyrshme e saj, simptomat e së cilës janë paqja dhe lufta: kur

---

<sup>34</sup> Po aty, f. 18.

<sup>35</sup> Po aty.

pasojat e sëmundjes mbahen nën kontroll, kemi paqe dhe kur sëmundja del nga kontrolli, kemi luftë. Në origjinë nuk janë të kundërta me njëra-tjetrën, sepse synojnë të njëjtën gjë: mbijetesën e shoqërisë nga sëmundja permanente. Si paqja, ashtu dhe lufta kanë repertorin e tyre të mundësive, teknikave, skemave, për të realizuar sipas rastit (a radhës) funksionin e tyre për mbijetesën e shoqërisë. Dhe secili prej dy repertorëve ka dy ndarje: teknika dhe skema të përshtatshme dhe teknika e skema të papërshtatshme. Vetëm këtu shfaqet i sigurt dallimi më esencial mes luftës dhe paqes: teknikat dhe skemat e papërshtatshme të luftës kanë pasoja ekstreme, të pakthyeshme (të pakthyeshme, sepse fuqia shkatërruese e tyre është më e lartë se inkubacioni i prirjes familjarizuese të qenieve njerëzore) dhe mbi të gjitha, për këtë arsye lufta është e papranueshme. Ndërkohë që teknikat dhe skemat e papërshtatshme të paqes, me gjithë shëmtinë dhe ngadalësimin degjenerativ të sëmundjes së shoqërisë, janë gjithsesi të pranueshme vetëm për arsyen dhe për atë që si rregull e lejojnë inkubacionin e aftësisë familjarizuese të pjesëtarëve të shoqërisë. Sidomos në këtë kuptim, është e vërtetë teza e Mishel Fukosë<sup>36</sup>, që vetëm për atë që mund të jetë lufta vazhdim i politikës me mjete të tjera, është edhe politika vazhdim i luftës me mjete të tjera. (Që për sa na përket, do të themi: edhe paqja është vazhdim i luftës me mjete të tjera).

Pas djegies së këtyre dy mundësive në kushtet e rehabilitimit, çfarë i mbetej këtij grupi, ishte ose të hiqte dorë nga protagonizmi politik dhe nga gara për pushtet, duke mbetur për inerci një grup i parëndësishëm i shoqërisë shqiptare, ose t'i bashkëngjitej një force politike të re, e cila përfaqësonte aspiratën mbarëpopullore për rrëzimin e sistemit të vjetër dhe ngritjen e një sistemi të ri. Duke shpresuar që përmes kësaj force të kontribuonte në këtë proces dhe t'i jepte vetes si grup mundësinë të rimëkëmbje. Pra, rikthimi përmes rehabilitimit, për fat të keq të këtij grupi, e bëri të pashmangshme detantën si marrëdhënie mes dy palëve të Luftës Civile, në kushtet e reja të pas pasluftës represive. Duhet të theksojmë se të tilla kushte u krijuan në Shqipëri pas viteve 1990. Thua se i gjithë spektri politik nuk e përkrahu grupin e të persekutuarve. Në një mënyrë ose një tjetër iu kundërvunë asaj. Ky grup i cili kishte provuar represionin për gjatë 50 vjetëve nuk kishte as forcë, as burime njerëzore që të luftonte. Pjesa më e madhe e tyre u mjaftuan vetëm me lirinë që fituan, duke dalë nga burgjet apo duke ikur nga kampet e internimit. Ata madje edhe fëmijët e tyre i kishin të pashkolluar, kështu që ishte e vështirë t'i ftoje në revansh. Ajo çfarë i mbetej këtij grupi, ishte ose të hiqte dorë nga protagonizmi politik dhe nga gara për pushtet, duke mbetur për inerci një grup i parëndësishëm

---

<sup>36</sup> Rudian Zekthi, Gazeta "Panorama", Revansh, 11 nëntor 2016.

i shoqërisë shqiptare, ose t'i bashkëngjitej një force politike të re, e cila përfaqësonte aspiratën mbarëpopullore për rrëzimin e sistemit të vjetër dhe ngritjen e një sistemi të ri. Duke shpresuar që, përmes kësaj force, të kontribuonte në këtë proces dhe t'i jepte vetes si grup mundësinë të rimëkëmbje. Pra rikthimi përmes rehabilitimit, për fat të keq të këtij grupi, e bëri të pashmangshme detantën si marrëdhënie mes dy palëve të Luftës Civile, në kushtet e reja të pas Pasluftës Represive<sup>37</sup>.

Veç kësaj, klasa e të persekutuarve, duke qenë që kishin provuar persekutimin në të gjitha dimensionet, pjesa më e madhe e tyre u pajtuan thjesht dhe vetëm me një rehabilitim. E djathta që sa vinte dhe po kishte në gjirin e saj pjesëtarë nga shtresat komuniste, filloi t'i përjashtonte nga mjaft procese politike. Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare rrallë shohim të ketë pjesëtarë nga të persekтуarit. Edhe partia e cila i mbështeti, rrallë i ka bërë pjesë të zgjedhjeve politike. Këtu padyshim ka të bëjë edhe qëndrimi i vetë grupit të të persekutuarve, të cilët mbase nga lodhja apo mosbesimi nuk janë treguar këmbëngulës në luftën e tyre për t'u bërë faktorë në zhvillimet politike në vend. Kjo mbase lidhet edhe me frikën dhe mosbesimin që ky grup ka nga persekucioni i madh që kanë kaluar.

Viti i fundit i Luftës së Dytë Botërore për shqiptarët nuk qe vetëm luftë ndaj pushtimit nga Gjermania naziste, por edhe një vit intensiv lufte civile, mes ushtrisë së komunistëve shqiptarë të udhëhequr në një luftë partizane prej PKSH-së themeluar më 1941 dhe reparteve të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, dy organizata politike antikomuniste me bazë tek elitat e paraluftës. Për emërtimin e këtij viti si luftë civile nuk ka dakordësi, paçka se prova më evidente e saj është pikërisht paqja pas luftës: gjatë kësaj paqeje që zgjati raskapitshëm nga viti 1945 deri në vitin 1990. Grupet që dolën të humbur nga lufta e dyfishtë (çlirimtare dhe civile) u persekutuan me një vijimësi dhe pandjeshmëri të tillë që mund të krahasohet me rastet më të këqija të persekutimit në kohë paqeje që njeh historia e njerëzimit.

Brenda këtij persekutimi të madh, ajo që ndodhi në kampin e punës në Tepelenë, është vetëm një pjesë e së tërës, por që për nga mizoria me të cilën u ekzekutua segregimi dhe diskriminimi i pjesës më të dobët (e nga ky fakt, të palejueshme për t'u dëmtuar) të grupeve që humbën luftën (pra i grave dhe fëmijëve të tyre), ajo që ndodhi në këtë kamp, shërben edhe për të kuptuar se paqja pas Luftës së Dytë Botërore qe vazhdim i luftës civile, por edhe për të kuptuar se shoqëria shqiptare është duke vuajtur edhe 33 vjet pas mbylljes së kësaj paqeje (shfrytëzuar si periudhë e gjatë mpirjeje gjenocidale për një pjesë të shoqërisë nga ata që patën pushtetin) pasojat e saj:

---

<sup>37</sup> Rudian Zekthi, gazeta "Panorama", 17 janar 2020.

mosnjohja e luftës së 1943-1944 si luftë civile dhe mosnjohja e 1945-1990 si gjenocid i komunistëve në pushtet ndaj kundërshtarëve politikë të tyre, mjafton për të shpjeguar ndasinë e thellë edhe sot në shoqërinë shqiptare mes të majtëve dhe të djathëve, mes Jugut dhe Veriut, mes pushtetsynuesve dhe zhvillimsynuesve.

Kjo mosnjohje (brenda së cilës dhe qindra jetë të njoma të fëmijëve të të mundurve të luftës civile, të humbura në Kampin e Tepelenës) paraqet si mundësi: ose në zhbërjen përfundimtare të grupeve të mundura në luftë civile dhe të persektuara në paqe, ose një reflektim nga pala fituese e luftës. Në të dyja rastet shembujt nuk janë pozitivë. Referenca me këto dy ngjarje për Tepelenën do të linte një shije të keqe, të cilën populli i tij është përpjekur ta shlyejë me punë dhe përgjegjësi qytetare dhe demokratike.

## *6. Përfundime*

Në mbyllje mund të pohojmë se Kampi i Tepelenës është simbol i dy luftërave, luftës për çlirim nga fashistët dhe luftës midis Partisë Komuniste dhe kundërshtarëve politikë të saj. Në fazën e parë Tepelena ishte thjesht një kamp fushimi për ushtarët italianë dhe gjithashtu u bë qendër e luftës për dëbimin e tyre më 1920. Ky qytet, së bashku me kampin e tij, u bë aksidentalisht territori që u përfshi në Luftën Italo-Greke. Përfshirja në këtë luftë që thjesht për arsye strategjike, të cilën Tepelena së bashku me kampin i plotësonin më së miri. Pas çlirimit të vendit më 1944, ngjarjet politike të zhvilluara në vend i japin një tjetër drejtim Tepelenës dhe kampit brenda tij. Pikërisht aty, mbi territorin e kampit të Luftës Italo-Greke, u ndërtua kampi i internimit të kundërshtarëve politikë të regjimit komunist. Kampi i Tepelenës ka qenë nga më të tmerrshmit në historinë e kampeve në Shqipëri. Aty janë përdorur tortura nga më çnjerëzoret. Gjatë viteve 1949-1954 Tepelena, për shkak të kampit të internimit, mori ngarkesa negative si qytet në ligjërimet politike. Gjithsesi Tepelena dhe populli i saj, me punë të ndershme, me shpirt patriotik, është përpjekur të heqë konotacionin e keq të emrit të kampit, por kurrësi vuajtjet dhe persekutimet. Të vuajturit e këtij kampi duhej të kishin luftuar për të qenë faktor i rëndësishëm në zhvillimet politike pas viteve '90. Edhe partia e cila i mbështeti, rrallë i ka bërë pjesë të zgjedhjeve politike. Këtu padyshim ka të bëjë edhe qëndrimi i vetë grupit të të persektuarve të Tepelenës e më gjerë, të cilët mbase nga lodhja apo mosbesimi nuk janë treguar këmbëngulës në luftën e tyre për t'u bërë faktor në zhvillimet politike në vend. Kjo mbase lidhet edhe me frikën dhe mosbesimin që ky grup ka nga persekucioni i madh që kanë kaluar.

## *Bibliografi*

Akademia e Shkencave e RPSSH, *Fjalori enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Shtëpia Botuese “Toena”, vol. III, Tiranë 2007.

Canaj, C.: *Historia e ndërtimit të kazermave ushtarake në Tepelenë, Lufta Italo-Greke*, kumtesa e mbajtur në simpoziumin, “Tepelena në dy kohë”, gusht 2023.

Courtois-Werth-Panne- Paczkoëski-Bartosek-Margolin, *Libri i zi i komunizmit*, Shtëpia Botuese “Besa”, Tiranë 2000.

Dervishi, K.: Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri, *Burgjet dhe kampet Shqipërisë Komuniste*, Shtypshkronja “Maluka”, Tiranë 2015.

Duka, V.: *Histori e Shqipërisë 1912-1990*, Shtëpia Botuese “Kristalina K-H”, Tiranë 2007.

Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Shtëpia Botuese “Ideart”, Tiranë 2003.

Ficher, F.: *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Shtëpia Botuese “Cabej”, Tiranë 1999.

Meta, B.: *Tensioni greko-shqiptar, 1939-1949*, Shtëpia Botuese “Geer”, Tiranë 2002.

Rudian Zekthi, Revansh, Gazeta “*Panorama*”, 11 Nëntor 2016.

Wikipedia, parë më 10.08.2023, ora 9.